




Republika e Kosovës
Republika Kosova – Republic of Kosovo

ORGANI SHQYRTUES I PROKURIMIT
TELO ZA RAZMATRANJE NABAVKE
PROCUREMENT REVIEW BODY



PSH.nr. 125-19

PANELI SHQYRTUES, i emëruar nga kryetari i OSHP-së në bazë të nenit 105 dhe nenit 106 të Ligjit nr. 04/L-042, për Prokurim Publik të Kosovës, i plotësuar dhe ndryshuar me Ligjin 04/L-237, Ligjin 05/L-068, dhe Ligjin 05/ L-092, si dhe në mbështetje të nenit 53, të Ligjit me nr. 05/L-031, për procedurën e përgjithshme administrative në përbërje z. Blerim Dina – Kryetar, z. Nuhi Paçarizi - Anetar, z. Goran Milenković - Anëtar, duke vendosur sipas kërkesës së datës 23.05.2019, parashtruar nga AK – Komuna Prishtinë, për korrigjimin e vendimit të OSHP-së, me nr. 125/19, të datës 24.04.2019, që ndërlidhet me procedurën e prokurimit: “Kërkesë për propozim për PPP, për Parkingun nëntokësor në Prishtinë”, me numër të prokurimit 616-18-072-5-1-2, më datën 11.06.2019 mori këtë:

V E N D I M

I. **SHFUQIZOHET**, vendimi i OSHP-së, i datës 24.04.2019, me numër. 125/19, që lidhet me procedurën e prokurimit me titull: “Kërkesë për propozim për PPP, për Parkingun nëntokësor në Prishtinë”, me numër të prokurimit 616-18-072-5-1-2, të iniciuar nga Autoriteti Kontraktues (AK) – Komuna Prishtinë.

II. **PEZULLOHET**, procedura e prokurimit për aktivitetin e prokurimit me titull “Kërkesë për propozim për PPP, për Parkingun nëntokësor në Prishtinë”, me numër të prokurimit 616-18-072-5-1-2, të iniciuar nga Autoriteti Kontraktues (AK) – Komuna Prishtinë, deri në nxjerrjen e vendimit tjetër.

A R S Y E T I M

Autoriteti Kontraktues / Komuna Prishtinë, më datën 23.05.2019, përmes shkresës, ka kërkuar nga OSHP, korrigjimin dhe rishqyrtimin e vendimit të datës 24.04.2019, me numër. 125/19.

Organi Shqyrtues i Prokurimit, përkatësisht paneli shqyrtues pas pranimit të shkresës / kërkesës, e ka trajtuar dhe shqyrtuar me kujdes të njëjtën kërkesë dhe pas administrimit të të gjitha provave shkresore, ka

konstatuar se përmes vendimit të shfuqizuar, gabimisht i është referuar dispozitave ligjore dhe gjendjes faktike, rrjedhimisht është anuluar aktiviteti i prokurimit, dhe atë duke iu referuar raportit të ekspertizës të datës 08.04.2019, ku përmes të njëjtit raport përveç që është përshkruar gabimisht procedura e prokurimit edhe shqyrtimi i pretendimeve ankimore është bërë sipas ligjit nr. 04/L-042, për Prokurim Publik të Kosovës, i plotësuar dhe ndryshuar me Ligjin 04/L-237, Ligjin 05/ L-068, dhe Ligjin nr. 05/ L-092.

Procedura e prokurimit e iniciuar nga Autoriteti Kontraktues me titull “Kërkesë për propozim për PPP, për Parkingun nëntokësor në Prishtinë”, me numër të prokurimit 616-18-072-5-1-2, ka të bëjë me Partneritet Publik – Privat, rrjedhimisht ka qenë dashur që ankesa e operatorit ekonomik: “Nuha Bauuntemehmung” GmbH&Co, KG& “Qamili Gbr”Alba Clean” – Gjermani, të shqyrtohet dhe trajtohet sipas dispozitave të Ligjit nr. 04/L-045, për Partneritet Publik Privat. Prandaj si rezultat i shqyrtimit dhe hartimit të gabueshëm të raportit të ekspertizës, paneli shqyrtues përmes vendimit tani më të shfuqizuar gabimisht i është referuar dispozitave ligjore.

Paneli shqyrtues konform nenit 117 të LPP-së, dhe në mbështetje të nenit nenit 53, të ligjit me nr. 05/L-031, për procedurën e përgjithshme administrative, si dhe duke u bazuar në atë që u përshkrua si më lart vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

KËSHILLË JURIDIKE:

Kundër këtij vendimi nuk është e lejuar ankesa, por pala e pakënaqur me kërkesëpadi mund t'i drejtohet vetëm Gjykatës themelore-Departamentit për çështje Administrative për kompensim dëmi ne afat prej 30 ditësh nga data e pranimit të vendimit



Vendimi t'i dorëzohet:

- 1x1 AK – Komuna Prishtinë,
- 1x1 OE- Nuha Bauuntemehmung” GmbH&Co, KG& “Qamili Gbr”Alba Clean” – Gjermani
- 1x1 Arkivës së OSHP-së;
- 1x1 Për publikim në web- faqe të OSHP-së.